

VENDIM

Nr. 298, datë 8.4.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 153, DATË 7.4.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË KODIT RRUGOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 120/1, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me vendimin nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 7, e nenit 25, ndryshohet, si më poshtë vijon: “7. Në rastet kur pemët mbillen si elemente të trupit të rrugës, në funksion të rehabilitimit të gjelbërimit të skarpateve të rrugës, pemët mbillen në brezin e përkatësisë, jashtë bankinës, pa cenuar sinjalistikën vertikale rrugore. Largësia nga kufiri rrugor, jashtë qendrave të banuara, që duhet respektuar nga pronarët e terreneve në kufi me pronësinë rrugore, për të mbjellë pemë anash rrugës, nuk mund të jetë më e vogël se sa lartësia më e madhe e arritshme, për secilin tip, e rritjes, deri në plotësimin e ciklit vegjetativ.”.

b) Neni 312/1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 312/1 Leje drejtimi me pikë (neni 120/1 i Kodi t Rrugor)

1. Sasia e pikëve që i zbriten çdo mbajtësi lejedrejtimi mjete, për rastet e shkeljes së normave të sjelljes, është sipas lidhjes nr. 1, “Tabela e pikëve për shkeljet e normave të sjelljes”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Mbajtësi i lejedrejtimit që ka humbur totalin e pikëve dhe mbajtësi i lejedrejtimit, i cili, pas njoftimit të shkeljes së parë, që përfshin një humbje prej, të paktën, pesë pikësh, kryen edhe dy shkelje të tjera, brenda dymbëdhjetë muajve nga data e shkeljes së parë, që kanë të bëjnë me shkurtim prej, të paktën, pesë pikësh secila, duhet t’i nënshtrohet provimit të kualifikimit teorik në Drejtoritë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

3. Në rastet e përmendura në pikën 2, të këtij neni, mbajtësit i tërhiqet leje drejtimi nga organet e Policisë Rrugore dhe, së bashku me vendimin për heqjen e pikëve, i dërgohen Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Rifitimi i pikëve, me anë të provimit të kualifikimit teorik, është i vlefshëm pas përfundimit të kohës së pezullimit të lejedrejtimit.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor përgatit dhe administron procedurat e regjistrimit dhe të dhënies së provimit të kualifikimit teorik.

5. Tarifa e regjistrimit dhe e provimit të kualifikimit teorik miratohen nga ministri përgjegjës për transportin, në bazë të statutit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

6. Pyetjet e provimit të kualifikimit përzgjidhen nga kapitulli 5, “Normat e sjelljes”, të Kodit Rrugor.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor përgatit strukturën dhe pyetjet e provimit të kualifikimit teorik, të cilat i publikon në faqen e saj të internetit, së bashku me përgjigjet respektive.

8. Mbajtësi i lejedrejtimit fiton provimin e kualifikimit kur përgjigjet saktë, jo më pak se, 90 përqind të sasisë së pyetjeve.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama